



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1041 Prot

Tiranë, më 20.12.2021

V E N D I M

Nr.162, datë 20.12.2021

Për saktësimin e statusit të punësimit për punonjësen *** , emëruar me Urdhrin nr. 11, datë 16.01.2018 “Për emërimin në detyrë dhe lidhje kontrate individuale”, të Kryetarit të Bashkisë Kurbin, në detyrën “Audituese e brendshme” në këtë bashki.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

VËREJ SE:

Nëpërmjet informacionit të regjistruar me nr. 1041 prot, datë 19.11.2021, dërguar nga punonjësja ***** , me detyrë “Audituese e brendshme” në Bashkinë Kurbin, kërkohet një vlerësim nga ana e Komisionerit, nëse pozicioni i punës ku është emëruar kjo nëpunëse është pjesë e shërbimit civil dhe a e gëzon ajo statusin e nëpunësit civil, në këtë pozicion.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të hetimit administrativ për vlerësimin e informacionit të mësipërm, konstatohet se punonjësja ***** , ka filluar marrëdhënien e punësimit në Bashkinë Kurbin, me Urdhrin nr. 11, datë 16.01.2018 “Për emërimin në detyrë dhe lidhje kontrate individuale”, të Kryetarit të kësaj bashkie, në pozicionin “Audituese e brendshme”.

Nga përmbajtja e dokumentacionit të mësipërm, sqarohet se punonjësja ***** fillimisht ka qenë me detyrë financiare në Ndërmarrjen e Rrugë-Kanalizimeve (*institucion në varësi të Bashkisë Kurbin*), subjekt ky që nuk përfshihet në fushën e shërbimit civil e më pas, me Urdhrin nr. 11, datë 16.01.2018 “*Për emërimin në detyrë dhe lidhje kontrate individuale*”, të Kryetarit të Bashkisë, është emëruar “*Audituese e brendshme*” në Bashkinë Kurbin. Siç vërehet edhe në emërtimin e aktit, kalimi i saj në pozicionin e audituesit të brendshëm, është kryer pa iu nënshtruar procedurës së konkurrimit, marrëdhënie e cila rregullohet në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

Nga ana tjetër, prej shqyrtimit të strukturës së Bashkisë Kurbin, rezultoi se pozicioni i punës “*Audituese e brendshme*”, është një pozicion që përfshihet në shërbimin civil dhe si i tillë, ai mund dhe duhet të plotësohet vetëm nëpërmjet kryerjes së procedurës së konkurrimit, të parashikuar nga nenet 21 - 24, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Në këto kushte, duke qenë se marrëdhënia aktuale e punësimit të punonjësës ***** nuk është lidhur në respektim të kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil, arrihet në përfundimin se ajo nuk mund të jetë pjesë e shërbimit civil.

Për rrjedhojë, bazuar në përcaktimin e pikës 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, sipas së cilës, çdo emërim në pozicion ekzekutiv, në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil është “*absolutisht i pavlefshëm*”, marrëdhënia e punësimit të punonjësës ***** nuk është marrëdhënie në shërbimin civil. Për këtë arsye, njësisë përgjegjëse të Bashkisë Kurbin *i lind e drejta dhe detyrimi*, të urdhërojë menjëherë ndërprerjen e kësaj marrëdhënie punësimi dhe të marrë masat për plotësimin e pozicionit nëpërmjet procedurës së konkurrimit, sipas rregullave të legjislacionit të shërbimit civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe në nenet 16 dhe 35, të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Për rregullimin e gjëndjes së ligjshmërisë, Njësia e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Kurbin, të marrë masa të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për

punonjësën *****, si dhe të shpallë menjëherë pozicionin të lirë, për plotësimin e tij sipas rregullave të legjislacionit të shërbimit civil.

2. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat 15 ditë, nga marrja dijeni e vendimit.
3. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
4. Në rast të mos respektimit të vendimit, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimin dhe në zbatim të përcaktimit të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës, për moszbatimin e masës së përcaktuar në dispozitivin e vendimit.
5. Të njoftohet për këtë vendim, Njësia e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Kurbin dhe punonjësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha